

4.3.6. Mbrojtja e të Dhënave Personale

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është pothuajse plotësisht e kompletuar me staf dhe janë miratuar të gjitha pjesët e legjislacionit zbatues. Agjencia ka bërë përpjekje të përkushtuara për të ndritur vetëdijen rreth punës së saj përmes një numri aktivitetimesh që kanë pasur cak organet publike dhe private. Ajo ka zhvilluar një seri inspektimesh të drejtpërdrejta *ex officio* dhe të përgjithshme. Agjencia ka ofruar edhe komente për projektligje. Agjencia e mbanë një zyrtar (mbrojtës) me orar të plotë në polici.

Agjencia vazhdon të përballet me vështirësi në rekrutimin e stafit nga komunitetet pakicë. Aktivitetet operationale të Agjencisë janë rritur, por i duhet edhe më shumë për të kapur momentumin. Agjencia ka nevojë të ngrisë edhe më tej kapacitetet e veta dhe ekspertizën. Agjencisë i duhet të ketë qasje proaktive dhe të pavarur në kontrollet, si në sektorin privat edhe në atë publik. Çështjet/shqetësimet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale në polici duhen adresuar me shpejtësi.

Përgjithësisht, mbrojtja e të dhënave personale në Kosovë është në fazën e hershme. Agjencia ka nevojë ta mbështesë zbatimin e legjislacionit në sektorin publik dhe atë privat. Ajo duhet të jetë më proaktive dhe të veprojë në mënyrë të pavarur.